

Bekimi për Çairin e Ri

*(program i qeverisjes katërvjeçare të kandidatit për kryetar
të Komunës së Çairit, Bekim Sali)*

Shtator, 2021

Të dashur qytetarë të Çairit, çdokush në jetë e ka trajektoren e rrugës së tij jetësore, e cila të ndjekë njësoj siç nuk mund të ndahet hija prej trupit.

Meqë vij nga një familje ku buka është fituar vetëm me djersë dhe pa asnjë mbështetje shtetërore, jeta më ka mësuar se punët e mira bëhen vetëm me mund dhe se nuk ka asgjë më të vlefshme në jetë sesa suksesi i arritur me punë.

Kështu, pas ngritjes së disa kapaciteteve që i kam bërë për veten, për familjen time dhe për një rreth më të ngushtë njerëzish, gjykova se ka ardhur koha që kontributin tim ta jap përtej këtyre rrahëve.

Si njeri i lindur e i rritur në Çair, e kam kuptuar se e mira personale dhe familjare nuk ka kurrfarë kuptimi dhe vlere nëse nuk është në kohezion me të mirën e përgjithshme shoqërore. Kjo ka qenë shtytja që, përkundër detyrimeve të mia profesionale dhe afariste, vendosa ta pranoj sfidën për të garuar për kryetar të Çairit. Dhe, pasi që kjo kandidaturë është bërë zyrtare, shumë miq e dashamirë më kanë këshilluar se po i hyj një beteje për një detyrë e cila edhe kur bëhet me nder, siç do ta bëj sigurisht unë, ka pak mundësi të ofrojë rezultate të dukshme, kjo për shkak të degradimit sistematik në këto 15 vitet e fundit që ia kanë bërë komunës sonë ata që e kanë keqqueverisur në të kaluarën. Megjithatë, duke iu falënderuar secili për këshillat, unë përsëri mendoj se ka hapësirë të shpëtohet Çairi ynë. Mjafton ta ndalim degradimin, ta ndalim korrupsionin, ta stopojmë nëpërkëmbjen e hapësirës publike dhe të ofrojmë punë transparente dhe të dobishme për qytetarët e Çairit. Kjo do të krijonte një mundësi të re për menaxhimin e komunës sonë dhe një shpresë se edhe në Çair mund të jetohej më mirë.

Prandaj, do të dal në zgjedhjet lokale të kësaj vjeshte për ta kërkuar votën e secilit banor të Çairit i bindur se mund ta bëjë atë një lagje të banueshme, ta integroj në mozaikun e Qytetit të Shkupit dhe, mbi kaosin e rrëmujën e shkaktuar ndër vite, të mundësoj një rend dhe rregull që do t'i japë frymë tjetër këtij vendbanimi.

Se çfarë (nuk) kanë bërë të tjerët me Çairin, kjo për mua është më pak e rëndësishme dhe, madje, as që dua të merrem me të. Këtë tashmë e dinë të gjithë dhe ajo i takon të kaluarës. Po ta ndalni secilin qytetar në Çair dhe t'ia parashtroni një pyetje të thjeshtë se “Cila është cilësia e jetës së tij në Çair?”, përgjigja është sikur të flitet për informacionin më të njohur në botë, sepse Çairi është bërë ndër lagjet më të papërbalueshme për jetë jo vetëm në Shkup dhe në Maqedoninë e Veriut, por edhe më gjerë në Europë. Dhe, fajtorët për këtë nuk janë anonimë dhe të panjohur. Ata i njeh secili qytetar i Çairit dhe unë nuk mendoj se duhet t'ia kujtoj dikujt se kush janë ata, si i kanë emrat dhe sa e si e kanë shkatërruar ata Komunën.

Unë ia kam dhënë vetes për detyrë që të ofroj zgjidhje për problemet e shumta në Çair, të gjej mundësi për realizimin e projekteve dhe këtë ta bëj në mënyrën më transparente, ashtu që pas katër vjetëve kur ta takonicilindo qytetar në Çair, ai të jetë në gjendje të numërojë dhjetëra gjëra që i ka ndjerë si ndryshim në komunën e tij brenda kësaj kohe.

Kandidatura ime është një ofertë për marrëveshje me qytetarin e Çairit. Jo si “kontratat” e të kaluarës që kishin për synim mashtrimin, por kjo është një marrëveshje ku unë pranoj të jem kryeargati i Komunës së Çairit, ndërsa qytetari i Çairit të jetë kryepronari i punës sime. Unë, vullnetarisht, kam vendosur që katër vjetët e ardhme të jetës sime t'ia dedikoj Çairit, duke qenë i bindur se e di saktë se si mund të bëhet edhe komuna jonë një lagje e urbanizuar e Qytetit. Jam këtu që ëndrrën time për Çairin e Ri ta shndërroj në Çair të ëndrrave tona!

Tashmë ka përfunduar koha e fjalëve të mëdha. Po vjen koha e punëve të mëdha. Aty do të më gjeni mua. Na priftë e mbara!

Bekim Sali

Kandidat për kryetar të Komunës së Çairit
Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA

Çair, shtator 2021

Bashkë me kandidatin për kryetar të Komunës, në këtë garë janë edhe kandidatët për këshilltarë, të cilët e pasqyrojnë dhe përfaqësojnë më së miri qytetarin e Çairit. Ata janë djemtë, vajzat, burrat dhe gratë më të mira që i kemi në Çair, të cilët kanë vendosur po ashtu ta japin kontributin e tyre për një Çair të Ri. Disa prej tyre kanë ngjyra politike, disa janë aktivistë të shoqërisë civile, ndërsa disa janë thjesht me identitet Çairi, por të angazhuar në jetën publike dhe, si të tillë, kanë shfaqur dëshirë që të kandidohen për të qenë zëri i qytetarëve në Komunë, por edhe që ta mbështesin kandidatin Bekim Sali dhe projektin e tij për Çairin e Ri.

Lista e kandidatëve për këshilltarë në Këshillin e Komunës së Çairit e koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA:

1. ZuhdiEnez – Koka
2. NafieSelmani
3. XhelalHajdar
4. Muhamed Krasniqi
5. Sevim Hoxha
6. BeqirIsmailKubur
7. FatihQaili
8. Nuri Alili
9. DiellzaElezi
10. NazmijeGashi
11. Abdullah Shabani
12. ErtanShaqiri
13. Zeqirija Ibrahimimi
14. Ramazan Çilafi
15. Mejreme Tusha
16. FionaAbazi
17. NebahatDolek
18. Blerta Jonuzi
19. SamedinXhemaili
20. Shaban Xhakolli
21. Severxhane Laçi
22. BujaminDolek
23. GilxhanEmin
24. Bajram Musliu
25. QazimZiberi
26. MedianaAmeti
27. Naim Bajrami

INFORMACIONE TË PËRGJITSHHME MBI KOMUNËN E ÇAIRIT

Komuna e Çairit është formuar me 15 prill 1976 me Ligjin për formimin e komunave në kuadër të Qytetit të Shkupit dhe për përcaktimin e zonave të tyre (“Gazeta Zyrtare e RSM” nr.8/76).

Komuna e Çairit është komunë në përbërje të Qytetit të Shkupit dhe kufijtë e saj janë të definuar me Ligjin e Qytetit të Shkupit (Gazeta zyrtare e RM, nr. 55/04). Komuna zë territor prej 3,52 km², në lartësi mbidetare prej 362 m dhe është e vendosur në qendër në raport me organizimin territorial të qytetit dhe kufizohet me komunat Butel, Qendër dhe Gazi Babë.

Në vitin 2005 Komuna e Çairit, me ndarjen territoriale, tashmë ka fituar kufij të ri, sepse asaj i janë bashkangjitur lagjet “Bit-Pazar” dhe “Jahja Pasha”, të cilat më herët kanë qenë pjesë e Komunës Qendër, ndërsa prej saj është ndara lagjja “Butel” me fshatrat përreth, që tash janë pjesë e Komunës së Butelit.

Numri i përgjithshëm i popullsisë në kuadër të Komunës së Çairit, sipas regjistrimit të vitit 2002 (sepse regjistrim tjetër të popullsisë nuk ka pasur pas këtij viti), është 64.773 banorë ose 3,2% nga numri i përgjithshëm i banorëve të R. së Maqedonisë. Duke pasur parasysh se territori i komunës është 3,52 km², del se dendësia e popullsisë në Çair është 18.400 banorë në një kilometër katrorë, një dendësi që ndoshta mund të jetë më e madhja në Europë. Sa për krahasim, dendësia në Qytetin e Shkupit ndryshon në pjesë të ndryshme të qytetit – dendësia mesatare është 888 banorë/km². Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2002, në Komunën e Çairit ka 17.107 familje dhe Çairi renditet ndër komunat me shkallë të lartë të natalitetit dhe shtimit natyror në R. e Maqedonisë së Veriut.

Pjesa më e madhe e popullsisë në Komunën e Çairit është me përkatësi etnike shqiptare (57%), ndërsa pastaj vijojnë maqedonasit (24,1%), turqit (6,9%), romët (4,8%), boshnjakët (4,6%), ndërsa bashkësitë e tjera etnike (vllahë, serbë) janë të përfaqësuara me përqindje më të vogël.

MASTER-PLAN PËR ÇAIRIN E RI

Duke ndjekur ndër vite degradimin që iu ka bërë Çairin tonë, kemi menduar shumë, jemi konsultuar me shumë profesionistë dhe kemi vizituar shumë qendra të zhvilluara botërore për të marrë ide, propozime e zgjidhje se si mund të zgjidhet problemi i Komunës së Çairit. Kemi një sipërfaqe prej 3.52 km², kemi dendësi të jashtëzakonshme të popullatës që numëron gjithsej 64.773 banorë (18.400 banorë në një kilometër katror), kemi jashtëzakonisht pak hapësirë të lirë për të projektuar ndonjë zonë që do të sjellë të ardhura për Çairin, kemi pak hapësirë për zona të gjelbra dhe shumë hapësira të uzurpuar e me ndërtime pa leje...Të gjitha këto fakte të pamëshirshme të detyrojnë të mendosh se ndryshimet në Çair nuk duhet të nënkuptojnë dizajn kozmetik të pjesshëm, porse një projekt që rrënjësisht mund ta ndryshojë Çairin tonë. Prandaj, para se të kandidohem, e kam analizuar mirë se cila është zgjidhja për këtë kaos urban dhe për këtë katrahurë të ndërthurur ndër vite.

Kur shtrohet kjo, të gjitha sugjerimet e ekspertëve shpijnë në një zgjidhje – ankand ndërkombëtar publik për master plan për Çairin e Ri. Prandaj ne do të hapim konkurs publik ndërkombëtar për ta kërkuar projektin më të mirë të arkitekturës urbane për Çairin e Ri. Gjithçka tjetër është arnim mbi arnim dhe mashtrim mbi mashtrim, siç kanë bërë kryetarët e deritanishëm të Çairit, të cilët përmes fotografive e dizajnit të bukur janë përpjekur të thonë se kanë ndonjë zgjidhje dhe ne e shohim tashmë rezultatin e tyre.

Ankandi publik do të hapet duke e përshkruar hapësirën e Çairit, duke i përshkruar objektet kulturore-historike, por edhe zonat e tjera të rëndësishme në aspektin ekonomik, social, kulturor dhe shpirtëror, si dhe duke e përshkruar infrastrukturën aktuale, në mënyrë që propozuesit ta kenë parasysh se kjo komunë është e ndarë në dy pjesë: në njërin anë janë lagjet e vjetra me shtëpi të vjetra e disa të meremetuara, por edhe me disa ndërtesa të futura në mënyrë artificiale brenda tyre, e cila jeton në kushtesubstandarde dhe pjesa tjetër, e ndërtesave të ndërtuara në vitet 1960-1990, që ndonëse janë projektuar dikur si hapësira me të gjitha standardet, sot për shkak të mbipopullimit dhe uzurpimit të hapësirave të lira, por edhe për shkak të vjetërimit të tyre, po shndërrohen në zona që bien nën standardin minimal të jetesës.

E pasi që të zgjidhet projekti më i mirë urbanistik për Çairin, ky do të prezantohet para qytetarëve dhe, si i tillë, përmes një referendumi të iniciuar nga Komuna, do të kërkohet të miratohet nga qytetarët e Çairit. Natyrisht, ne – si menaxhment i Komunës – do të bëjmë fushatë që ai të kalojë. Dhe, kur të ketë kaluar projekti për Çairin e Ri, ne do të gjejmë rrugë për zbatimin e tij. Tashmë kemi komunikuar me disa kompani ndërkombëtare që janë të gatshme për projekte të tilla dhe unë kam besim të thellë se puna më e lehtë do të jetë të gjenden investitorë për realizimin e projektit “Çairi i Ri”.Na duhet vetëm një referendum i suksesshëm për Çairin e Ri. Pjesa tjetër është detyrë dhe kënaqësi e jona.

Kjo është arsyeja që programi im në këto zgjedhje përqendrohet më shumë në temën e Çairit të Ri, ndërsa premtim-zgjidhjet e dhëna në këtë program janë të tilla që të ofrojnë zgjidhje që e lehtësojnë jetën në këto kushte të Çairit, me mundësi që ato të jenë të përdorshme edhe në projektin e ardhshëm të Çairit të Ri.

Prandaj, thirrja ime në këtë fushatë është “Për Çairin e Ri”.

VIZIONI

Transparenca dhe kyçja e qytetarëve në ndërtimin e jetës në Komunën e Çairit dhe transformimi i komunës është një nga synimet tona prioritare, sepse ne jemi ndryshe nga qeverisjet e subjekteve tjera politike dhe Komunën e Çairit e shohim si një shtëpi e përbashkët për të gjithë qytetarët, ku me kontribut të përbashkët dëshirojmë ta kemi vend ideal për një jetesë me standarde europiane.

Përfshirja e politikave të qytetarëve do të jetë prioritet, kjo me të vetmen arsye që komuna të jetë një institucioni ku qytetarët t'i drejtojnë të gjithë hallet e tyre, idetë, nevojat dhe atë pa procedura burokratike, duke e lehtësuar kështu komunikimin me to në kohë reale nëpërmjet një aplikacioni mobil për të paraqitur, kërkuar dhe informuar procese që lidhen drejtpërdrejt me komunën dhe qytetarët. Me qasje të këtillë besojmë thellë se, duke krijuar një afërsi me qytetarët, do të jemi shumë më afër problemeve qytetare dhe, nga ana tjetër, qytetarët e Çairit do të ndjehen pjesë e proceseve, ashtu siç edhe duhet të jetë një komunë bashkëkohore.

Me këtë program, përmes të cilit synojmë transformimin e komunës me anë të projekteve të parapara për katër vitet e ardhshme, po ashtu qëllim bazë kemi krijimin e sa më shumë mundësive për punësim dhe krijimin e mundësive dhe kushteve që të rinjtë tanë të mos kenë synim largimin nga vendi dhe të sigurojnë të ardhmen jashtë shtetit tonë, sepse Çairi është komuna ku çdokush mund ta ndërtojë Dinjitetin e tij! Për këtë arsye ne kemi njëri-tjetritin burimin më të madh të forcës.

Me këtë program, që synon të ndryshojë konceptin e deritanishëm të politikës, duke dashur të sjellë më shumë bashkëpunim, më shumë punë, më shumë të ardhura, më shumë transparencë, jemi të sigurt që Çairin do ta kemi shtëpinë tonë të përbashkët, ku do të mund të jetojmë me nder e krenari.

Synimet kryesore

Qëllimet që do t'i radhisim para jush janë premtime për realizimin e të cilave zotohemi se do t'i përmbushim duke bashkëpunuar me ju, qytetarë të nderuar, por edhe me institucionet relevante, sektorin joqeveritar, sektorin e bizneseve, si dhe një pjesë të tyre në bashkëpunim me pushtetin qendror, kjo si rezultat i kompetencave të përcaktuara me ligj.

- Pjesëmarrja e qytetarëve në projektet dhe aksionet e ndryshme për Komunën e Çairit.
- Qasja transparente ndaj të gjitha punëve komunale dhe ofrimi i shërbimeve transparente online për të gjitha kategoritë e qytetarëve.
- Renovimi, kujdesi dhe mirëmbajtja arkitektonike e shkollave fillore dhe krijimi i infrastrukturës së shkollave me kushte europiane.
- Krijimi i kushteve optimale në qytet për rininë, që mundësitë për punësim dhe ndërtim të një ardhmërie t'i gjejnë në Komunën e Çairit.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me sektorin e bizneseve private dhe krijimin e kushteve dhe klimës së përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të tyre,
- Tërheqja e investimeve dhe zhvillimi i barabartë i Komunës.
- Krijimi i kushteve të volitshme për investime në mjeshtëritë artizanate.
- Tërheqja e bizneseve të huaja duke krijuar kushte dhe mundësi të volitshme për investitorët e jashtëm.
- Mbështetja maksimale e artit dhe kulturës, si dhe mbështetjeje e artistëve të Komunës së Çairit.
- Promovim i artistëve tanë brenda dhe jashtë Komunës.
- Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i të gjitha pikave turistike të Komunës me qëllim të tërheqjes së turistëve, si të vendit, ashtu edhe të huaj.
- Krijimi i kushteve dhe mundësive për sporte kolektive, me qëllim të angazhimit më të lartë të rinisë sonë në sporte të ndryshme.
- Krijimi i të gjitha kushteve të favorshme dhe mundësive për personat me aftësi të kufizuara, si dhe inkuadrimi i tyre në të gjitha sferat e jetës.
- Mbështetja dhe ndihma e vazhdueshme për të moshuarit.
- Rritja e pjesëmarrjes së gjinisë femërore në pozita udhëheqëse, si dhe rritja e barazisë gjinore në të gjitha organet dhe institucionet që janë nën qeverisjen e pushtetit lokal në Çair.
- Bashkëpunimi i plotë dhe transparent me sektorin civil, organizatat joqeveritare dhe mediat.

PARIMI THEMELOR I PUNËS – LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE TRANSPARENCA E PLOTË

Problemi më i madh në Komunën e Çairit, përveç ndarjes së dëmshme territoriale, është korrupsioni dhe mafia urbane, që zaptin hapësira të lira dhe përfiton për hesape të veta. Të gjitha të dhënat flasin se Çairi nuk ka mundur të prosperojë pikërisht për shkak të dozës së lartë të korrupsionit dhe prirjes për zaptimin e pronës publike për përfitime personale, që ka pamundësuar realizimin e shumë projekteve të rëndësishme infrastrukturore. Sipas Center for Economic Analyses, Komuna e Çairit është ndër komunat më jotransparente në menaxhimin e financave publike.

Prandaj ne jemi të bindur se vetëm nëse ndalet uzurpimi i pronës publike, korrupsioni, rryshfeti dhe abuzimi me detyrën zyrtare, në Çair krijohet klimë e favorshme për të pasur mirëqenie dhe që qytetarët të mos vuajnë për gjërat më elementare për jetë.

Nisur nga kjo, premtojmë se pushteti ynë në Çair do të jetë deri në fund transparent, me raporte publike javore, dhe, madje, denoncues ndaj të gjitha formave të këtilla devijuese që mund të shfaqen. Secili që denoncohet se abuzon me detyrën zyrtare për dobi personale nuk do të mund të jetë pjesë e stafit të Komunës së Çairit. Në fakt, nuk ka asnjë ligj hyjnor e tokësor që e lejon abuzimin me publikun.

Meqë gjatë këtyre viteve Komuna e Çairit është bërë çerdhe për punësime sezonale dhe fiktive të disa qindra aktivistëve partiakë, të cilët i paguajmë ne me tatimet tona, e jo një servis për qytetarët, duke kaluar madje në diktaturë dhe hakmarrje ndaj të gjithëve që mund të kenë mendimin e tyre të lirë politik etj., është bërë detyrim i lartë që Komuna e Çairit t'u kthehet qytetarëve dhe të eliminohet trysnia politike ndaj të gjithë qytetarëve që janë të punësuar në administratë komunale ose në institucionet e themeluara nga Komuna.

Me ne qytetarët e Çairit do të jenë të lirë dhe do ta ndjejnë komunën si institucion që u shërben atyre, pavarësisht bindjeve të tyre ideologjike, politike ose religjioze dhe pavarësisht përkatësisë së tyre etnike. Perëndia i ka falë njerëzit të lirë dhe askush nuk ka të drejtë t'i robërojë!

SIGURIA PUBLIKE NË ÇAIR

Gjatë këtyre viteve të administrimit të Çairit një nga problemet themelore ka qenë siguria publike. Përveç vjedhjeve dhe dëmtimit të pronës publike e private, në jo pak rastekemi pasur edhe vepra të krimit të rëndë, si vrasje në pikë të ditës e dëme që seriozisht e kanë kërcënuar jetën e qytetarëve në Çair. Nëse kësaj i shtohet fakti se në Çair ekziston një stacion policor, madje se kryeshefin e tij e propozon kryetari i Komunës, është për t'u habitur që kjo nuk ka reflektuar më shumë siguri në Çair.

Detyra jonë në këtë rast është që:

- Kryeshefi do të jetë profesionist dhe jo aktivist partiak;
- Do të hapen tri pika policore brenda në lagjen e Çairit (një mes Gazi Babës dhe Seravës – diku në Çariçankë, një në Çarshi dhe një në Xhon Kenedi – që do ta mbulojë Dizhonin, Tophanën dhe lagjen e ndërtesave), në mënyrë që policia të jetë sa më afër qytetarëve dhe në mënyrë që patrullat e policisë të jenë vazhdimisht në terren dhe të sigurojnë veprim të shpejtë dhe profesional në dobi të qytetarëve;
- Do të krijohet një patrullë policie mobile, që do të kujdeset vetëm për objektet publike (shkolla, çerdhe, teatër...);
- Komuna do të ndajë buxhet për sigurimin 24-orësh të Çarshisë së Shkupit, si dhe për sigurimin e të gjitha objekteve publike (personel dhe mbikëqyrje me kamera);
- Çarshia e Shkupit do të behet një vend ku shërbimet tradicionale do të bëhen më efikase dhe më vizibile, sidomos me përdorimin e zgjidhjeve digjitale në dobi të qytetarëve, bizneseve dhe turistëve. Për këtë qëllim në Çarshinë e Shkupit do të investohet në kamera, sensorë të ndryshëm, kjo me qëllim që nëpërmjet kornizës dhe lidhshmërisë së IoT, Inteligjencës Artificiale, kjo pjesë e komunës sonë të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat që Çarshia e Shkupit të bëhet SMART. Synimi ynë është që ky vend të jetë i mrekullueshëm për t'u vizituar dhe me standarde botërore për t'u vendosur në hartën e “Qyteteve të Zgjuara” (Smart City).
- Për shkak të kaosit në trafik, policia rrugore do të jetë vazhdimisht nëpër rrugët e Çairit, për ta rregulluar komunikacionin;
- Do të rritet ndriçimi publik si mundësi për parandalimin e rrezikut;
- Do të respektohet rreptësisht ligji në relacion me bastoret dhe kazinotë.

ÇAIRI ME KOMUNIKACION FUNKSIONAL

Një ndër problemet themelore në Çair është gjendja e rrugëve, në kuptim të dëmtimeve, por edhe rrëmuja në rrugë, ndërsa veçanërisht problem i madh është bërë mungesa e parkingjeve. Në krejt hulumtimet që i kemi bërë, gati në të gjitha lagjet e Çairit problemi i parkingut është ndër problemet më të mëdha.

Rrugët

- Meqë në Çair ka rrugë që janë kompetencë të qytetit të Shkupit, do të na duhet bashkëpunim me Qytetin e Shkupit, për të bërë zgjidhje për disa rrugë dhe bulevarde që bien në territorin e Çairit. Zaten, ato janë kalimet më të frekuentuara. Vetëm përmes bulevardeve Cvetan Dimov dhe Hristijan Todorovski Karposh çdo ditë kalojnë rreth 200 mijë qytetarë që banojnë në veri të Shkupit, andaj në rripin e Jahja Pashës gjithnjë kemi problem dhe rrëmujë. Janë tre opsione për ta zgjidhur këtë problem:
 - 1) ta zgjerojmë rrugën (të bëhet me tre korsi në të dy anët), që nënkupton shpronësim dhe dëmshpërblim (sipas llogaritjes sonë është opsioni më i lirë);
 - 2) të ndërtojmë një mbikalim nga ura e Bit Pazarit deri në bul. Bosnja e Hercegovina (kostoja është më e shtrenjtë) dhe
 - 3) të bëhet një nënkallim me nga tre korsi në të dyja anët, që do ta lidhë Urën e Bit Pazarit me bul. Bosnja e Hergovina (ky është opsioni më i shtrenjtë). Vendimi përfundimtar do të merret pasi të bëhet vlerësimi i kostos financiare dhe i gjetjes së fondeve, ndërsa meqë kjo rrugë është nën ingerencat e Qytetit të Shkupit, do të duhet të koordinohet së bashku me autoritetet e Qytetit. Megjithatë, synimi ynë është ta realizojmë opsionin e tretë, sepse kështu prodhojmë një shëtitore mes Seravës dhe Gazi Babës, në të cilën do të kalojnë vetëm autobusët dhe pjesa tjetër do të jetë trotuar, shteg për biçikleta dhe hapësirë ndërlidhëse. Kjo do të analizohet me autoritetet e Qytetit të Shkupit dhe do të dilet me një plan konkret varësisht nga kostoja financiare. Gjithsesi master plani për Çairin e Ri do ta ketë të zgjidhur këtë problem.
- Bul. Hasan Prishtina (e a.q. Rruga e Plastikave) kërkon një menaxhim tjetër. Aty së pari do të vendoset rend në ekspozimin e mallrave, në mënyrë që të krijohet hapësirë edhe për këmbësorët, por edhe për parkim të veturave në pozitë paralele me rrugën. Kjo i ndihmon edhe bizneset, por edhe mundëson qarkullim më të lehtë. Komuna e Çairit, me buxhetin e saj, do të asistojë këtu duke e ndarë trotuarin për parkim dhe për këmbësorë.
- Ndarje e këtitillë e trotuarit do të bëhet edhe në bul. Xhon Kenedi, ngase shfrytëzimi i tij vetëm për parkim e pengon kalimin e këmbësorëve.
- Në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit, përmes ankandit publik, do të kërkohet zgjidhje që rr. Llazar Trposki të lidhet me bul. Hasan Prishtina, në mënyrë që të shkarkohet bul. Cvetan Dimov dhe të mundësohet një arterie tjetër për ndërlidhjen e qendrës me veriun e Shkupit.
- Për shkak të vendosjes së Universitetit Ballkanik, ndërtimit të xhamisë së re në Fushë Topanë, kompleksit Viva Fresh dhe ndërtimeve të tjera, së shpejti problem do të jetë edhe bul. Makedonsko-Kosovska Brigada. Aty do të duhet të bëhet një zgjerim i mirë, që do të mundësojë lidhjen e shpejtë deri te Rruga e Plastikave. Gjithsesi edhe ky projekt do të duhet të realizohet në koordinim me Qytetin e Shkupit.
- Sa u përket rrugëve në lagjet e vjetra brenda Çairit, aty do të vendoset rendi i trafikut me rrugë njëkahëshe, që nuk do të jetë vetëm me shenja komunikacioni, por edhe me

mekanizëm rrugor që e pengon makinën të lëvizë në anë të kundërt. Kjo vlen për lagjet Seravë, Gazi Babë, Dyqanxhik, Dizhon dhe Teneqe Mëhallë. Duke e vendosur këtë rend, mund të krijohet edhe mundësi parkimi në rrugët pak më të gjera, nga njëra anë e rrugës, por edhe frekuentim pa pengesa të makinave nëpër këto rrugë.

- Problem që do ta zgjidhim janë edhe stacionet e taksive, të cilët tash janë në një kaos. Komuna do t'i përcaktojë edhe vizualisht pikat e taksive, ku ata do të mund të ndalen vetëm në ato vende, por edhe asnjë makinë tjetër nuk do të mund të ndalet në vendet e parapara për taksë. Po ashtu do të themelohet një zyrë e taksistëve. Gjithë kjo do të realizohet me buxhet të Komunës.

Parkingjet

Na Komunën e Çairit janë të regjistruara rreth 12.000 makina, që zënë një hapësirë parkimi prej rreth 140.000 metra katrorë ose 1.4 km katrorë. Kjo për një komunë, që ka gjithsej 3.5 km katrorë, është gati e paimagjinueshme të ketë hapësirë të mjaftueshme parkimi. Prandaj, në konkursin publik për Çairin e Ri ndër pikat më të rëndësishme është zgjidhja për parkingjet.

Ndërkohë, derisa të arrijmë në implementimin e master-planit “Çairi i Ri”, propozimi ynë është që ky problem i madh për Çairin të zgjidhet në disa mënyra:

- garazhe nëntokësore nën oborret e objekteve publike (me fonde ndërkombëtare si UNDP e Banka Botërore, që ndihmojnë për mbrojtjen e mjedisit)
- Kur të vendoset rendi i rrugëve njëkahëshe brenda në lagje, krijohet mundësi për parkingje në rrugët që janë të gjera 4-6 metra;
- Parkingjet përreth ambulancës do të jepen për menaxhim privato-publik, me atë që pronarët e makinave të banorëve të Çairit do të paguajnë shumë simbolike (300 den. në muaj) dhe do të kenë etiketë për t'i shfrytëzuar të gjitha parkingjet e në Çair;
- Parkingjet përreth ambulancës, parkingjet afër sheshit Skënderbeu, parkingu në Çairçankë, parkingu te Rruga e Plastikave, parkingjet pas ndërtesave në XhonKenedi dhe parkingu te Xhamia e Re e Çairit do të bëhen parkingje me dy kate të montuara. Kjo do të bëhet me partneritet publiko-privat ose me buxhet komunal – varësisht prej interesimit për investim;
- Pas analizës që do të bëhet se ku është nevoja më e madhe, do bëjmë që kjo praktikë e parkingjeve të montuara në dy kate të përdoret sa më shumë në Çair;
- Do të krijojmë zyrë në Komunë që do të merret me parkingjet, me numrin e makinave dhe me gjetjen dhe përgatitjen e të gjitha hapësirave publike për parkim. Kjo do të vlejë veçmas për pjesën e ndërtesave, por edhe për hapësirat brenda në Komunë. Analiza jonë flet se përkundër numrit të madh të makinave, ekzistojnë mundësi për ta zgjidhur këtë problem. Si në çdo qytet të botës, parkingu do të jetë shërbim me pagesë, por i garantuar dhe i sigurt.

Qarkullimi në Çair

- Për shkak të dendësisë së madhe të popullsisë dhe aksidenteve që ndodhin, shpesh edhe me pasoja fatale, vendimi i Komunës së Çairit do të jetë që shpejtësia maksimale e makinave në rrugët që i menaxhon Komuna e Çairit të jetë 30 km. në orë. Kjo është shpejtësi me të cilën, sipas profesionistëve, nuk mund të ndodhin dëme të mëdha edhe në rast të aksidenteve.

- Meqë çdo ditë po rritet numri i biçikletave dhe trotinetëve elektrikë nëpër rrugët e Çairit, do të kujdesemi që ata në secilën rrugë ta kenë shtegun e tyre.
- Po ashtu, meqë një numër i madh i qytetarëve të Çairit lëvizin në këmbë, do të mundësohet që secila rrugë ta ketë të shënuar edhe shtegun për këmbësorë dhe trotuaret të jenë të rregulluara.
- Në mënyrë që të pakësohet numri i makinave nëpër rrugët e Çairit, do të mundësohet që nëpër bulevardet kryesore të ketë biçikleta ose trotinetë publikë, njëjtë sikurse në shumë qytete tjera të botës. Për këtë qëllim Komuna do të bëjë një master-plan, me qëllim që të krijojë një zgjidhje të qëndrueshme për çiklizmin në komunën tonë, duke mundësuar:
 - o Siguri më të madhe në trafik për çiklistët;
 - o Qasje të lehtë dhe të lirë për biçikletat;
 - o Trafik vizibël të biçikletave;
 - o Semaforë të dedikuar për çiklistët.
- Komuna do të bëjë disa stacione ku do të mund të merren biçikletat, që do të jenë në pronësi të Komunës, për t'u shfrytëzuar nga ana e qytetarëve. Për këtë qëllim do të bëjmë një softuer “ÇAIR eBIKE”, të cilin çdo qytetarë do të mund ta instalojë në telefonin e tij, me çka do të ketë mundësi që të përdorë biçikletën e Komunës. Këto biçikleta do të jenë të brenduara dhe me çip për siguri.
- Rrugët kryesore do të jenë të përshtatura për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta dhe për ata që janë të verbër.

ÇAIRI I RI ME INFRASTRUKTURË MODERNE DHE TRANSFORMIM DIGJITAL

Nuk kemi zbuluar asgjë nëse themi se në Çair kemi infrastrukturë të vjetruar dhe të pa mirëmbajtur, sepse secili shi që bie në Çair e argumenton këtë konstatim.

Ndërtesat kanë problem me shtypjen e ujit, lagjet e vjetra kanë problem me ujërat e zeza dhe ujërat atmosferike, ndërsa ndriçimi publik lë shumë për të dëshiruar.

Në Çair janë 135 banesa kolektive, prej të cilave 25% kanë ashensor, ndërsa 35% kanë objekte afariste. Problem i madh për banesat kolektive është mirëmbajtja e tyre. Meqë janë ndërtesa të vjetra, shumë sosh kanë ashensorë të vjetër, fasada të dëmtuara, dritare të vjetra, kanë mungesë të çative, vërehet problem me ndriçimin dhe sigurinë e hyrjeve, me mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të ndërtesave kolektive, si dhe problem me sigurinë në dhe rreth ndërtesës.

- Kjo është arsyeja që ne do të themelojmë një zyrë të veçantë në Komunë e cilado të merret me çështjen e ndërtesave. Zyra për Përkrahje të Ndërtesave kolektive do të ofrojë këto mundësi:
 - o Përkrahje teknike dhe materiale që secila ndërtesë të themelojë Këshill Banesor ose të angazhojë një ndërmarrje për menaxhimin e hyrjes së banesës;
 - o Komuna secilin vjet do të ndajë buxhet prej 250.000 EUR, për të subvencionuar meremetimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e banesave, të cilat – pasi të kenë regjistruar Këshill Banesor – do të mund të aplikojnë për grant mbështetës, i cili do të përdoret për ashensor, për renovim energjetik të fasadave, për hidrofors, për zëvendësim të dymëve të hyrjes ose të dritareve të vertikales së shkallëve. Grantet do të ndahen me transparencë dhe në procedurë të hapur për të gjitha ndërtesat e Komunës pa favorizime e anime.
 - o Me anë të mundësive për partneritet publiko-privat, Komuna duke bashkëpunuar me ndërmarrjet që prodhojnë dhe tregtojnë energji solare, do të gjejnë zgjidhje për t'i mbuluar me çati ato ndërtesa që nuk kanë çati, kjo në kompensim me panelet diellore, që do të vendosen mbi çati, prej të cilave do të mbulohen edhe një pjesë e shpenzimeve të ndërtesave për energji elektrike;
 - o duke aplikuar në fonde si HabitatMaqedoni, Banka Botërore, BERZH, UNDP, EIB, USAID, etj., me ç'rast Komuna do të participojë me një përqindje të paracaktuar, do të gjejnë zgjidhje për fasadat e vjetruara;
 - o do të investojmë për ndriçim me drita LED me sensorë, në mënyrë që të kurset energjia elektrike;
 - o Do të krijojmë sistem GIS për Komunën e Çairit, me çka menaxhimi me infrastrukturën e rrugëve, dritave, mbeturinave, sinjalizimit, si dhe sigurisë së qytetarëve do të menaxhohen në kohë reale.
- Ndonëse konkursi publik për Çairin e Ri do të japë zgjidhje, ndërkohë nëpër lagjet e vjetra do të punojmë në lehtësimin e jetës, duke e riparuar rrjetin e ujësjellësit, që të përshtatet me nevojat reale të qytetarëve dhe, veçanërisht, do të gjejnë zgjidhje për ujërat e zeza të lagjes Seravë, një problem ky i kamotshëm. Të gjitha këto riparime do të jenë më bashkëkohore, në mënyrë që të jenë në funksion edhe në Çairin e Ri.
- Dritat LED me sensorë për ndezje/fikje do t'i përdorim dhe për ndriçimin publik, ngase ato janë drita që edhe kursejnë energji elektrike, por edhe mundësojnë ndriçim sipas nevojës. Në ndriçimin publik këto drita do të furnizohen me energji solare, ashtu që edhe më shumë do të kurset energjia elektrike.

Tashmë të gjithë e dimë se teknologjitë digjitale i optimizojnë dhe lehtësojnë proceset e biznesit, proceset edukativo-arsimore, si dhe aspektet e ndryshme jetësore. Ato sigurojnë qasje të shpejtë dhe të lehtë në informacion, ndërsa lehtësojnë dhe mundësojnë një mori shërbimesh për qytetarët në të gjitha aspektet e jetës lokale (arsimi, administrata publike, mobiliteti, informimi i qytetarëve, turizmi, kultura, etj.). Përveç kësaj, tanimë është botërisht e njohur se teknologjitë digjitale e inkurajojnë zhvillimin ekonomik, e nxisin inovacionin dhe transparencën.

Megjithatë, transformimi digjital, zakonisht, anashkalohet nga institucionet publike dhe ato nuk e kanë në fokus digjitalizimin në nivel të institucionit.

Natyrisht, zbatimi i politikave efektive për "qytete inteligjente" (*smart cities*) nuk varet vetëm nga komunat dhe mund të bëhet në mënyrë efektive vetëm në një kontekst ku luftohet ndarja digjitale që prek një pjesë të qytetarëve, duke u siguruar mbulim 4G, si dhe WIFI cilësor dhe me çmim të arsyeshëm në gjithë territorin.

- Ne do të punojmë që çdo qytetar të ketë qasje në internet, si një e drejtë themelore njerëzore. Duke siguruar internet në të gjithë territorin e Komunës, do të zvogëlojmë pabarazinë digjitale në popullatë dhe do të mundësojmë ndërveprim me qytetarët e komunës në kohë reale.
- Duke dhënë mundësi për qasje në internet për çdo qytetar, do të vazhdojmë t'i inkurajojmë ata për përvetësimin e njohurive teknologjike përmes edukimit joformal, që Komuna do ta ofrojë në mënyrë sistematike, duke krijuar mundësi aftësimi për çdo qytetar dhe biznes lokal.
- Shërbimet komunale do t'i digjitalizojmë dhe në këtë mandat 4-vjeçar do të krijojmë qeverisjen elektronike (ose e-qeverisjen), e cila përveçse do të ndihmojë për efikasitet, do t'i ulë edhe kostot komunale. Përvojat e ndryshme ndërkombëtare dëshmojnë se në vendet ku qeveritë kanë zbatuar programe të e-qeverisjes, është ulur dukshëm niveli i korrupsionit, kjo përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke kontribuar kështu edhe në forcimin e qeverisjes së mirë. Kjo qasje do të ndihmojë në afrimin e shërbimeve deri te qytetarët dhe do të jetë një mjet efektiv në luftën kundër korrupsionit, duke siguruar më shumë transparencë, informacion të hapur dhe rritje të llogaridhënies

Ne do të angazhohemi për zbatimin e masave në vijim:

- Do të bëhet digjitalizimi i infrastrukturës administrative komunale, i cili do të kontribuojë në modernizimin dhe efikasitetin e të gjithë sektorëve në Komunë, si dhe ngritjen e cilësisë së jetesës për çdo qytetar.
- Transformimi digjital do të mundësojë që të përmirësohet zhvillimi, si dhe decentralizimi dhe transparenca e menaxhimit komunal. Shërbimet do të jenë më të shpejta, më eficiente dhe më të qasshme.
- Do të stimulojmë dhe përkrahim ide të reja për përmirësimin e infrastrukturës digjitale si në nivel komunal, ashtu edhe në nivel rajonal.
- Duke përmirësuar infrastrukturën digjitale dukshëm do ta zvogëlojmë edhe evazionin fiskal.
- Do të krijojmë sportele elektronike, që ofrojnë shërbime të vazhdueshme, 24 orë në ditë – 7 ditë në javë, të destinuara për të tërhequr dokumente komunale dhe certifikata, si dhe për të dorëzuar kërkesa administrative te shërbimet komunale.

- Do të krijojmë një platformë unike online për Çairin. Platforma online do të shoqërohet me një aplikacion komunal për informim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe ndërveprim në kohë reale me autoritetet komunale.
- Do të zbatojmë politikë të të dhënave të hapura (open data) dhe qasje të lirë në të dhënat me karakter të interesit publik për transparencë totale të përdorimit të mjeteve komunale, rekrutimeve në administratë dhe një menaxhim më të mirë të Komunës. Duke krijuar mundësi për qasje në të dhëna që janë me interes publik, do të garantojmë lirinë e shprehjes dhe të mediave, me çka për çdo komunë do të krijohen portale ndërvepruese për komunikim në kohë reale me mediat lokale, bizneset, organizatat joqeveritare, ato edukative, si dhe me çdo qytetar të Komunës. Kjo qasje do ta ulë kufizimin që mediat dhe shtypi e kanë pasur deri më tani, do ta rrisë dhe garantojë lirinë e shprehjes, si dhe do të ulë diskriminimin dhe ndarjet sociale dhe etnike.
- Do të krijojmë fond special për investime në teknologji, për mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale dhe për modernizimin e saj.
- Do të krijojmë një shërbim komunal për ndërhyrje të shpejtë për eliminimin e deponive të egra. Në këtë drejtim, do të investohet në krijimin e mundësive për qytetarët për të lajmëruar shërbimet kompetente përmes rrjeteve sociale ose përmes aplikacionit komunal.
- Do të bëhet fuqizimi i rrjetit të ndriçimit rrugor dhe përshtatja e tij me specifikat e hapësirës publike, në veçanti përmes ndriçimit inteligjent (ndriçim i bazuar në detektimin e lëvizjeve).
- Do të vendosen kontejnerë inteligjentë, të cilët sinjalizojnë në mënyrë elektronike kur janë të mbushur dhe furnizohen me energji nga panelet diellore.

ÇAIRI – ÇERDHE E ARSIMIT

Në Komunën e Çairit janë disa shkolla fillore, që ndonëse thuhet se janë meremetuar ose ndërtuar, ato vazhdojnë të kenë kushte minimale pune. Qoftë për nga pajisjet mësimore, qoftë për nga rendi në shkollë, qoftë për shkak të orarit të mësimimit në më shumë se dy turne, qoftë për shkak të punësimeve me karakter politik ose të nepotizmit, që kanë shkaktuar rënie të cilësisë, qoftë për shkak të mungesës së higjienës ose mungesës së hapësirave të mjaftueshme për rekreacion, shkollat fillore të Komunës së Çairit lënë shumë për të dëshiruar.

Duke qenë të vetëdijshëm se sa është i rëndësishëm arsimimi për emancipimin e një kombi, ne do të jemi maksimalisht të përqendruar në përmirësimin e nivelit të arsimimit nëpër shkollat e Komunës së Çairit. Së pari do ta luftojmë nepotizmin dhe politizimin e shkollave, ndërsa do të kërkojmë cilësi nga shkollat. Askujt nuk i lejohet ta marrë në qafë një komb për shkak të përfitimeve të veta politike. Drejtorët dhe arsimtarët do të jenë të lirë nga presionet politike, por do të jenë nën vëzhgim për cilësinë e tyre të punës. Do të stimulohet leximi, do të bëhet pasurimi i bibliotekave, do të motivohen shkollat për organizim të garave të diturisë, kuizeve të diturisë, ndërsa do të bëhet shpërblimi i lexuesve dhe nxënësve më të mirë etj. Ne jemi të bindur se detyra jonë parësore si komb është që të lexojmë më shumë. Gjithçka tjetër rezulton pas kësaj: një popull që lexon, avancohet; një popull që nuk lexon, stagnon. Detyra jonë mbetet pasurimi i bibliotekave me libra, ndërsa i shkollave stimulimi i leximit.

Nëse këto i shtrijmë në detyra konkrete, do të duken kështu:

- Departizimi i shkollave – arsimtari e merr vendin e punës për shkak të aftësisë e jopër shkak të përkatësisë politike, por edhe drejtori zgjidhet me këso kriteri;
- Në secilën shkollë do të mundësohet mësim tërëditor, sepse duke pasur gjithnjë e më shumë prindër që punojnë, vazhdimisht haset kjo nevojë;
- Digjitalizimi i lektyrave shkollore, në mënyrë që çdo arsimtar/nxënës t'i ketë lektyrat në versionin digjital dhe të mos ketë më arsye për mosleximin e lektyrave;
- Do të krijohet bibliotekë digjitale;
- Do të bëhet digjitalizimi i librave amë;
- Do të themelohet çmimit komunal për arsimtarin më të mirë, që do të jepet më 7 Mars, ndërsa – sipas modelit të çmimeve shtetërore – do të nënkuptojë edhe shpërblim financiar;
- Do të bëhet lidhja e shkollave me ngrohjen qendrore
- Komuna do të sigurojë shujta falas për nxënësit me gjendje të rënduar sociale;
- Komuna do të ndajë 50 bursa për nxënësit më të mirë të klasave VIII dhe IX;
- Do t'i nxisim shkollat për gara dhe kuize të diturisë, të cilat do të mbështeten nga Komuna. Kjo nënkupton se Komuna, me qëllim të ngritjes së kualitetit të mësimimit, do t'i mbështesë materialisht garat e këtilla, që nxënësit të garojnë mes vete dhe me nxënësit e komunave/qyteteve të tjera. Detyra e Komunës do të jetë shpërblimi financiar dhe mbështetja logjistike e nxënësve fitues dhe arsimtarëve të tyre;
- Do të krijojmë shkolla alternative – në Qendrën e Kulturës, Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (që do të themelohet), Komuna do të paguajë arsimtarë të lëndëve të caktuar, për t'u ndihmuar nxënësve që shfaqin dobësi në disa lëndë, por edhe për t'i avancuar ata që shfaqin prirje më të larta për mësim;
- Pranë secilës shkollë do të themelojmë edhe çerdhe (në partneritet me organizatat ndërkombëtare, si UNICEF, UNDP etj.);
- Nuk do të lejohet që të ketë klasa me më shumë se 25 nxënës;
- Do ta përshtatim hapësirën fizike të shkollës për nxënësit me nevoja të veçanta;

- Do të mundësojmë pajisjen e shkollave dhe kabineteve shkollore;
- Do të bëjmë ndërrimin e dyerve dhe dritareve të vjetra nëpër shkolla;
- Do të bëjmë zëvendësimin e bankave dhe karrigeve të vjetra me të reja;
- Parqet e shkollave do të bëhen inkubatorë të punës kreative të nxënësve;
- Veshja e nxënësve të shkollave fillore të Çairit do të jetë me uniforma që do t'i sigurojë Komuna me sektorin e biznesit;
- Do të bëjmë furnizimin e bibliotekave të shkollave me libra të autorëve vendas dhe botërorë;
- Secilës shkollë do t'i mundësojmë aparate për printim dhe fotokopje, si dhe letër falas për çdo shkollë/arsimtar;
- Çdo shkollë do të ketë mjaftueshëm video-projektorë;
- Do t'i çlirojmë oborret e shkollave nga objektet afariste të vendosura aty pa të drejtë;
- Do të bëhet riparimi dhe mbulimi i çdo çatie në shkollat fillore me panele solare për shfrytëzimin e energjisë diellore, me çka dukshëm do t'i ulim shpenzimet për ngrohje dhe ftohje në shkollë;
- Do të bëhet akreditimi i drejtimeve të reja në përputhje me nevojat e tregut të punës ("smart specialisations"), kjo në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit;
- Do të hapen qendra për aftësim profesional për të mbështetur arsimin joformal;
- Do të krijohen programe vjetore komunale për trajnim të arsimtarëve. Temat do të përcaktohen çdo vit në përputhje me rezultatet e fituara nga vlerësimet dhe studimi që do të bëhet në nivel komunal;
- Do të angazhojmë një orto-pedagog përgjegjës për zbulimin e vështirësive dhe çrregullimeve në mësim tek fëmijët;
- Do të krijohet një kuzhinë qendrore komunale, e cila do të punojë me fruta dhe perime të stinës, si dhe produkte organike për të promovuar një dietë të shëndetshme të nxënësit e shkollave fillore;
- Do të mundësojmë "shkolla ekologjike". Kjo nënkupton përfshirja e çerdheve dhe shkollave në programet komunale për kursim të energjisë, klasifikim të mbeturinave dhe mbrojtje të mjedisit, në bashkëpunim me ndërmarrjet përgjegjëse dhe zyrën komunale për energji.

Shkollat si mjedise të shëndetshme

Koncepti për shkolla që promovojnë shëndetin e ka origjinën nga simpoziumi i përbashkët i Organizatës Botërore të Shëndetësisë në vitin 1996 dhe grupi skocez për edukim shëndetësor i mbajtur në Skoci, ndërsa parimet bazë që mbështesin shkollën promovuese të shëndetit janë dizajnuar në Konferencën e Selanikut në vitin 1997.

Në kohën kur gjithë bota është përballur me virusin Covid-19 dhe shëndeti është bërë tema më e rëndësishme në botë dhe kur tashmë të gjithë e dimë se higjiena është mënyra më e suksesshme për parandalimin e kësaj sëmundje, ne mendojmë se detyra mbase më e madhe është e jona që Çairi të jetë mjedisi më i pastër publik, ndërsa në veçanti do të kujdesemi që shkollat të jenë mjedise të shëndetshme.

Në të vërtetë, shkollat luajnë një rol vital në zhvillimin dhe mbështetjen e fëmijëve. Duke zhvilluar mjedise të shëndetshme në objektet ku zhvillohet procesi edukativo-arsimor, ne kontribuojmë për suksesin e vet nxënësve.

Elementet bazë të një shkolle të shëndetshme janë qasja në kujdesin shëndetësor, ushqimi i shëndetshëm, aktiviteti fizik, ajri e uji i pastër, si dhe edukimi i nxënësve për të bërë jetë të shëndetshme. Një shkollë e shëndetshme është vendi ku nxënësit kanë shumë mundësi – në

klasë, gjatë pushimeve mes orëve të mësimit, aktiviteteve sportive – për të nxitur zhvillimin e tyre fizik, mendor, social dhe intelektual. Shëndeti në shkollat tona duhet të shtrihet përtej plan-programit mësimor dhe klasave, pra të jetë në të gjithë mjedisin shkollor.

Propozimi ynë është që lënda e Higjienës ose Edukata shëndetësore të bëhet lëndë mësimore, por meqë kjo varet nga pushteti qendror, ne do të përpiqemi ta bëjmë detyrën sa na lejojnë kompetencat.

Detyrat tona për shkolla të shëndetshme do të jenë:

- o Pastërtia personale fizike e nxënësve, arsimtarëve dhe personelit tjetër në shkollë;
- o Konsumimi i ushqimit të pastër në shkollë;
- o Kultivimi i mjedisit të pastër në shkollë;
- o Inkurajimi i nxënësve për një mënyrë jetese të shëndetshme nëpërmjet aktivitetit fizik gjatë qëndrimit në shkollë;
- o Stimulimi i dëshirës së nxënësve për aktivitete sportive;
- o Mbështetja materiale (financiare dhe logjistike) e garave sportive të nxënësve nga komuna.

QENDRA E KULTURËS, INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË “ÇAIR”

Duke ndjerë nevojën e qytetarit të Çairit për pasurimin e jetës kulturore, inovacionit dhe ndërmarrësisë si dhe nevojën për ngritje intelektuale, Komuna e Çairit do të ndërtojë një qendër ku do të krijohet një ekosistem për kulturën, inovacionin dhe ndërmarrësinë, me çka qytetarët e Çairit do të kenë një qendër me performanca europiane dhe ku do t'i realizojnë idetë, projektet apo proceset e biznesit për kompani startup. Kjo qendër do të vendoset në brendi të komunës (lokacioni do të caktohet pas analizës së hapësirës së mbetur publike).

Ne tashmë kemi vënë kontakte me bashki dhe komuna të Republikës së Turqisë, të cilat janë të gatshme ta marrim përsipër ngritjen e godinës si investim i tyre i plotë. Kërkesa e tyre është vetëm të sigurohet hapësira dhe plani.

Në këtë qendër do të organizohen trajnime, ekspozita, shfaqje të nxënësve të shkollave, ndërsa do të ketë mentorime dhe trajnime për profesione në fusha të ndryshme si për të rinj që kane ide inovative, ashtu edhe për artistë që dëshirojnë një kënd pune për krijim ose ekspozita të ndryshme. Në këtë qendër do të krijojmë programe edukative për trajnime edhe për nxënës, kjo për dy kategori: për nxënësit që shfaqin dobësi në disa lëndë dhe për nxënës me prirje në lëndë të caktuara, gjithë kjo me qëllim të përmirësimit të performancës në atë lëndë ose përgatitje për gara.

Komuna do t'i mbulojë 20-30 rroga të arsimitarëve, artistëve dhe mentorëve (ekspertë në fusha të ndryshe) që do të punojnë me të rinj, fëmijë dhe grupe të tjera të interesuara për të fituar dhunti të ndryshme. Përveç kësaj, Qendra do të ketë mundësi të gjenerojë mjete, duke i huazuar hapësirat e saj për nevoja të karakterit publik. Aktivitetet e kësaj qendre:

- Kurse për muzikë (violinë, kitarë, piano, mandolinë, klarinetë, çifteli, kavall);
- Kurse për art figurativ;
- Kurse të gjuhëve të huaja;
- Kurse të teknologjisë informatike;
- Kurse për zanate (qepje, zdrukthëtari, filigran);
- Kurse për matematikë;
- Aktivitete të lira për fëmijë, në të cilat do të zhvilloheshin edhe kurse përmes lojës, duke i përfshirë edhe fëmijët me probleme të ndryshme psiko-fizike, si ata që janë me autizëm, me sindrom daun dhe sëmundje të tjera, të cilët meritojnë kujdesin tonë etj.;
- Trajnime dhe mentorime për të rinjtë që kanë ide inovative për krijimin e startapeve;
- Krijimi i programit akcelerator për ide të reja inovative dhe ndërmarrje të reja.

Kjo qendër do të jetë shpirti i Çairit të Ri. Në kuadër të saj do të ketë edhe një bibliotekë moderne. Përveç arkitekturës moderne dhe joshëse që do ta ketë biblioteka e mbushur me koleksione librash, ajo do të ketë leximore dhe sallë për aktivitete të ndryshme kulturore, si dhe zyra të cilat do jenë në shërbim të qendrave për edukim, karrierë dhe inovacione.

Brenda saj do të ndërtohet një mur, i cili do të quhet MURI I SUKSESIT. Në çdo tullë të murit do të shkruhen emrat e njerëzve që kanë kontribuar në fushën e arsimit në Çair, për të treguar mirënjohje për punën dhe kontributin e tyre, si dhe për të qenë frymëzim për gjeneratat që vijnë pas.

ÇAIRI SI TRASHËGIMI KULTURORE

Kultura është element i rëndësishëm i avancimit të një kombi. Identiteti i një kombi krijohet përmes kulturës. Për këtë qëllim, si drejtues të Komunës së Çairit, do të ndihmojmë në fuqizimin e ansambleve aktuale folklorike, do ta ndihmojmë Teatrin e Dramës Shqipe dhe Teatrin e Fëmijëve (veçanërisht do të nxisim që nxënësit të jenë vizitorët e rregullt të teatrit), pastaj ansamblet e të gjitha etnive, do të ndihmojmë në krijimin e grupeve të ndryshme muzikore të të gjitha zhanreve, do të nxisim organizim të festivaleve për fëmijë, festivaleve të muzikës së lehtë dhe asaj popullore, do të stimulohen artistët figurativë, si dhe shkrimtarët që gravitojnë në Komunën e Çairit, që secilin muaj të këtë dhjetëra aktivitete kulturore, ndërsa për realizimin e tyre do ta vëmë në dispozicion edhe Qendrën Edukative Kulturore.

Në të vërtetë, në Komunën e Çairit vite me radhë po bëhet kulturocid i qëllimshëm. Duke i koncentruar të gjitha projektet kulturore ne anën tjetër të Urës së Gurit, artistët dhe kultura në Çair po mbetet në margjina.

Disa nga projektet të cilat i parashohim janë:

- Formimi i orkestrës vokale-instrumentale të Komunës së Çairit. Duke pasur parasysh numrin e artistëve të suksesshëm e profesionistë, të cilët banojnë në Komunën e Çairit dhe të cilët janë të papunë, orkestra vokale-instrumentale e Komunës së Çairit do të jetë nën përkujdesje institucionale. Në këtë mënyrë do të sigurohen drejtpërdrejt edhe ansamblet e këngëve dhe valleve popullore të Komunës së Çairit që të kenë orkestër. Orkestra e Komunës do të jetë pjesë e të gjitha ngjarjeve kulturore të organizuara nga Komuna e Çairit dhe do t'u shërbejë ansambleve të këngëve dhe valleve popullore në Çair.
- Përkrahja institucionale e grupeve formale dhe joformale të artistëve. Kjo nënkupton organizimin e projekteve inkluzive, ku secili artist do të ketë mundësi të investojë me kapitalin e tij intelektual në ngritjen e nivelit kulturor dhe artistik në Komunën e Çairit.
- Adaptimi i Parkut të Çairit, ndër të tjera, edhe për aktivitete të ndryshme kulturore: për panair të librit, panair të luleve, panair të zejtarëve, panair të prodhimeve autoktone, panair të kuzhinës tradicionale etj.

ÇARSHIA E SHKUPIT

Një trajtim të veçantë në pikën e kulturës e meriton Çarshia e Shkupit. Ajo, sipas nesh, duhet të jetë epiqendra urbane e qytetit të Shkupit. Zaten Shkupi u bë qytet këtu ku është sot duke u ndërtuar përreth Çarshisë dhe s'do mend se shkupjan je aq sa je i lidhur me Çarshinë. Në këtë kuptim për Çarshinë e Shkupit janë të rëndësishme dy aspekte:

1) *Aspekti ekonomik*

Në aspektin ekonomik Komuna e Çairit, bashkë me institucionet e tjera të pushtetit qendror, duhet ta krijojë plan për mbrojtjen e Çarshisë, për revitalizimin dhe mbrojtjen e autenticitetit të saj arkitektonik dhe për ruajtjen e artizanateve në Çarshi, për stimulimin e zejtarëve përmes projekteve të ndryshme, përmes kompensimit ose lirimit nga detyrimet ndaj Komunës dhe ndaj shtetit, që të mund të punojnë deri në orët e vona, pastaj brendimi dhe patentimi i produkteve të Çarshisë dhe mbrojtja e tyre ligjore etj.

Në këtë drejtim, planet konkrete janë:

- Miratimi i planit detal urbanistik për Çarshinë;
- Renovimi i rrjetit nëntokësor në Çarshi;
- Ndërtimi i tre tualeteve publike në Çarshi;
- Orari i Çarshisë do të zgjatet dhe Çarshia të jetët e ndriçuar në çdo cep;
- Meremetimi dhe rindërtimi i objekteve me vlerë kulturore që janë të rrënuara;
- Garazh dykatësh për parkim afër Kalasë;
- Rregullimi i komunikacionit për hyrje dhe dalje më të lehtë nga Çarshia;
- Rrjet interneti wi-fifalas për Çarshinë e Shkupit;
- Aplikacion interaktiv me hartën e Çarshisë dhe me guidë për çdo objekt (çdo objekt do të ketë ueb-faqen e tij, ku përmes QR-code do të mund të merren informacione për historinë dhe funksionalitetin e objektit ose pikës përkatëse).
- Organizimi i panairit të zejtarisë;
- Në bashkëpunim me Odën e Zejtarëve të Komunës së Çairit (e cila fatkeqësisht nuk është e formuar deri më tani), do të miratojmë plan dhe strategji për zhvillimin e zejtarisë me politika lokale, me masa dhe instrumente për zhvillim të shpejtë dhe pa pengesa të zejtarisë;
- Po ashtu në suazat e Odës së Zejtarëve të Çairit do të krijojmë një sistem informativ për kontakte me partnerët e jashtëm nëpërmjet sistemeve ndërkombëtare informative të punës;
- Rruga e Elitës – aty synojmë t'i vendosim brendet kryesore botërore, në mënyrë që Çarshia të bëhet një vend frekuentues për shopping;
- Krijimi i qendrave për trajnim;
- Krijimi i zyrave të hapura (Coworking space) me infrastrukturë teknologjike, ku çdo qytetar do të mund t'i shfrytëzojë ato për punë ose rekreacion;
- Krijimi i hapësirave për të kaluar kohën me familje (“bahçet e çajit”);
- Promovimi i prodhimeve unike të Çarshisë së Shkupit;
- Përmes Zyrës së Çarshisë, do të krijohen ura bashkëpunimi me objektet hotelierike brenda dhe jashtë Çarshisë.

2) *Aspekti kulturor*

Çarshia duhet të shërbejë njësoj si Stari Grad në Dubrovnik: të gjitha rrugë duhet të shpijnë në Çarshi. Angazhimi jonë është që Çarshia të jetë bërthama e Shkupit dhe atraksioni turistik. Të gjitha guidat turistike botërore do ta kenë në hartat e tyre Çarshinë. Ndërkaq aty, përveç kushteve elementare (si tualete e ulëse për pushim), duhet të mundësohet hyrje më e lehtë nga të gjitha anët, si dhe zyrë të veçantë, e cila prodhon materiale për promovimin e Çarshisë, organizon vizita nëpër të dhe e standardizon interpretimin e vlerave artistike të Çarshisë së Shkupit, duke mos lejuar që secili ciceron – varësisht prej bagazhit të tij – ta ndërtojë te vizitorët identitetin e Çarshisë. Për këtë qëllim gjatë gjithë vitit duhet të ketë projekte kulturore, artistike, por edhe argëtuese, që do t'i mbajnë turistët në Çarshi.

Kjo kërkon që Çarshia të ketë sa më shumë produkte unike, qofshin ato punime të dorës, por edhe ushqime, pije e gatime të veçanta, një spektër që do ta stimulojmë me qëllim që Çarshia të jetë një “pieont” për të gjithë që vijnë në RMV. Natyrisht, kjo nënkupton edhe përfitime ekonomike për dyqanxhinjtë në të.

Disa nga detyrat tona janë:

- Mbështetja e festivaleve ekzistuese muzikore;
- Organizimi i festivalit “Streetfood”, që do të ndikojë në rritjen e vizitorëve dhe në kapacitetet ekonomike të Çarshisë;
- Organizimi i festivalit të punimeve të dorës;
- Ekspozita permanente në hapësirë të hapur;
- Organizimii festivalit të poezisë;
- Organizimii festivalit të dramës në skenë të hapur.
- Java e inovacionit dhe ndërmarrësisë;
- Organizimi i Hackatonit në Çarshi.

Synimi ynë – “Sheshi i Çarshisë”

Synimi ynë është që, në marrëveshje me ndërmarrjen private “Skopski Pazar”, por edhe me tregtarët e Bit Pazarit – të cilët nuk guxojmë t’i dëmtojmë, të mund ta dislokojmë tregun e Bit Pazarit pas ambulancës, në mënyrë që hapësira e tregut të shndërrohet në një shesh, që do të fillojë nga xhamia e Allaxhës dhe do të vazhdojë në gjithë hapësirën deri në hyrje në Çarshisë. Në këtë mënyrë hapet edhe hyrja e Çarshisë, por edhe hyrja e Teatrit Shqiptar dhe kështu krijohet një shesh i madh. Vendosija e një shatërvani, e ulëseve dhe hijeve ia ndryshon pamjen jo vetëm Çarshisë, por edhe gjithë qytetit.

ÇAIRI – KOMUNË QË KUJDESET PËR SHËNDETËSINË

Komuna e Çairit ka trashëguar dy qendra shëndetësore (Shtëpia e Shëndetit “Bit Pazar” dhe Poliklinika “Çair”) dhe Mjekësinë e Punës, të cilat do të duhej të ishin të mjaftueshme për t’i mbuluar nevojat shëndetësore të qytetarëve të Çairit. Megjithatë, për shkak të mosorganizimit të brendshëm dhe problemit me qasjen në to, si dhe për shkak të mungesës së kuadrit, më shumë qytetarë u drejtohen ambulancave private, që po ashtu janë të shumta në Çair.

Duke e ditur se sa ka ngecur procesi i decentralizimit të dikasterit të Shëndetësisë, e dimë se pushteti lokal ka pak mundësi për të ndërhyrë në këto institucione të shëndetit publik, por ajo që mund të bëjmë ne është:

- Të mundësojmë qasje sa më të lehtë në qendrat e shëndetit publik – pacientët që shkojnë aty të mos paguajnë për parking;
- Të ushtrohet presion në Ministrinë e Shëndetësisë për kuadër, që shumë shpesh mungon;
- Të depolitizohen këto qendra, në mënyrë që mbi të gjitha të jetë shëndeti i njeriut.

ÇAIRI – KOMUNË E TË RINJVE

Sporti nuk është vetëm mënyrë argëtimi dhe kujdesi për shëndetin, që janë gjithsesi shumë të rëndësishme, por njëherazi paraqet edhe identitetin e një komuniteti. Një komunitet që merret me sport nënkupton një komunitet që është larg dukurive devijuese. Ndonëse në Çair ekziston një stadium futbollit dhe disa shkolla private sportive, angazhimi i Komunës së Çairit për sportin në Çair ka qenë dhe mbetet minimal ose simbolik. Aq më shumë që edhe stadiumi që është ka problem me qasjen në të, ndërsa aq shumë hapësira të tij janë uzurpuar dhe dhënë gjithandej për biznese të caktuara, sa ai gati ka mbetur lakuriq.

Synimi ynë është që të krijohet një qendër sportive “Shkupi”, në të cilën do të stimulojmë më shumë sporte. Për këtë nevojitet një hapësirë e re (stadiumi i Shkupit nuk e mundëson një gjë të tillë), andaj një qendër si ajo “Partizan” do të ishte mundësia më mirë për zhvillimin e sportit të rinjtë. Disa nga detyrat tona në këtë drejtim janë:

- krijimi i një palestere sportive që do të jetë nën ingerencat e Komunës;
- do të subvencionojmë anëtarësimin e të rinjve në klubet amatore sportive, të cilat nuk i financon komuna, si dhe lirin nga pagesa e anëtarësisë në klubet sportive që i financon Komuna;
- do ta subvencionojmë sportin për fëmijë dhe për vajza;
- do të investojmë për zhvillimin e “sportit në rrugë” dhe për shfrytëzim për qëllime sportive të hapësirave mes ndërtesave dhe nëpër lagje, duke krijuar fusha të vogla sportive (për futboll në gola të vegjël, basketboll, volejbol etj.)
- rikthimi i pishinës në Çair;
- Do të ngremë fond dhe program për krijimin e startapeve (të rinjtë e Çairit që kanë ide inovative, Komuna do t’u ndihmojë me trajnime, mentorime dhe buxhet për ta realizuar idenë dhe për të krijuar kompani);
- Krijimi i qendrave për inovacion (“innovation hubs”), inkubatorëve dhe përshpejtuesve, qendrave për arsim joformal dhe bibliotekave digjitale publike në çdo komunë. Këto qendra do të themelohen përmes partneriteteve publiko-private dhe do të shërbejnë si trampolina për ide të reja dhe inovacione, duke ndihmuar kështu shoqërinë dhe ekonominë lokale që të përballen me sfidat e së ardhmes dhe aspiratat e të rinjve. Përmes këtyre qendrave, çdo qytetar i komunës, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e tij, do të ketë një hapësirë për trajnim dhe zbatim të projekteve digjitale.

KOMUNA DO TË KUJDESET PËR PLEQTË

Gjatë kontaktit me qytetarë e kemi vërejtur se në Çair nuk ka asnjë hapësirë ku pensionistët mund të takohen dhe ta kalojnë ditën. Shumica e tyre rrinë në Parkun e Çairit, por kjo mundësohet vetëm kur është moti i mirë. Prandaj ne premtojmë se, gjatë mandatit katërvjeçar, do të hapim 6-10 “vatra” për pleq.

Ato janë zyra, qiranë e të cilave do ta paguajë Komuna, madje Komuna do ta sigurojë edhe mobilimin e tyre dhe do ta paguajë rrymën, ndërsa pensionistëve u mbetet të sigurojnë ushqime, çaj dhe gjëra të tjera. Disa nga këto “vatra” do të shërbejnë edhe për gratë pensioniste ose të vetmuara, që mund të shoqërohen me gra të moshës së tyre.

Për këtë qëllim Kryetari i Komunës do të angazhojë një të punësuar në Komunë, i cili do të kujdeset për këto “vatra”, për ndarjen e tyre në bazë të kërkesave për burra e gra, por edhe çështje të mirëmbajtjes së tyre.

Përveç këtyre hapësirave, Komuna e Çairit do të ofrojë edhe:

- trajnim falas për njohuri themelore teknologjike – përdorimi itelefonit “të mençur” dhe aplikacioneve të tjera në të;
- trajnime për pagesa online të faturave mujore.
- krijimin e një fondi për të përkrahur pleqtë e palëvizshëm, që jetojnë vetë ose ata me aftësi të kufizuara që të mund të marrin shërbime themelore mjekësore falas në shtëpitë e tyre. Këtë do ta realizojmë me personel mjekësor vullnetar dhe me personel mjekësor që do të lidhë kontrata në vepër me Komunën për ta ndihmuar këtë kategori të qytetarëve;
- duke synuar ta mbështesë vullnetarizmin, Komuna do të mundësojë që ata qytetarë që në mënyrë vullnetare kujdesen për pleq të vetmuar, të kenë lehtësime tatimore kundrejt Komunës.

Kuzhina publike për nevojtarë

Nga kalkulimet e kryqëzuara dhe informacionet që i kemi nga qendrat e punës sociale dhe organizatat humanitare, na rezulton se rreth 2000 familje të Çairit jetojnë në kushte shumë të rënduara ekonomike.

- Ndonëse për një pjesë të madhe të tyre kujdeset Qendra e Punës Sociale dhe organizatat bamirëse, Komuna e Çairit do të iniciojë që me buxhetin e saj të themelojë një kuzhinë publike për nevojtarët. Nuk guxon askush në Çair të bie në gjumë i uritur. Komuna do ta sigurojë objektin ose, varësisht nga nevojat, disa objekte ku të varfrit do të kenë falas tre shujta ditore.
- Fillimisht Komuna do të startojë me 500-1000 shujta ditore, të cilat do të mbulohen nga Qendra e Punës Sociale, përkatësisht Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa në bashkëpunim me donatorë të brendshëm dhe të jashtëm, do ta rrisë kapacitetin sa të ketë nevojë.
- Për shkak të specifikave kulturore që i ka popullata jonë (për shkak të presionit social mund të mos shkojnë të hanë në kuzhinën popullore), Komuna – me resurset e veta dhe në bashkëpunim me vullnetarë dhe organizata bamirëse – do të organizojë edhe transportimin e ushqimit nëpër shtëpi.

ÇAIRI I JETËS JOQEVERITARE

Aty ku nuk arrin dora e Komunës, mund të arrijë dora e aktivistëve të jetës joqeveritare. Prandaj, në perceptimin tonë, OJQ-të janë partnere dhe si të tilla do t'i trajtojmë.

- Komuna çdo vjet do të ndajë, nga buxheti i saj, grante në vlerë 3.000-5.000 EUR për projekte joqeveritare, ndërsa zyrat publike të Komunës do të jenë edhe në shërbim të OJQ-ve.
- Si staf i Komunës veçanërisht do të kemi interes për projekte edukative, por edhe projektet mjedisore e kulturore do të jenë njësoj të trajtuara nga ne.
- Interes i yni i veçantë do të jetë përkrahja e OJQ-ve ose e institucioneve që kujdesen për fëmijët ose të rriturit me nevoja të veçanta;
- Komuna do të sigurojë hapësira adekuate për shoqatat e personave me nevoja të veçanta;
- Komuna do të investojë në ndërtimin e kapaciteteve të reja për strehimin e personave në rrezik shoqëror, përfshirë viktimat e dhunës seksuale, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në komunën tonë etj.

ÇAIRI MULTIETNIK

Meqë Çairi është një komunë e diversitetit etnik, gjuhësor, religjioz e kulturor, ky identitet i Komunës duhet të shfaqet në të gjitha dimensionet e jetës publike në Çair. Për këtë qëllim Komuna do të themelojë një komision që do të kujdeset për ruajtjen e këtij ekuilibri, në të cilin do të jenë të përfaqësuara të gjitha komunitetet. Detyra e këtij komisioni do të jetë:

- të mbajë evidencë dhe të bëjë raporte për respektimin e diversitetit në Çair;
- të ndajë grantet për OJQ-të e ndryshme që e promovojnë jetën multietnike, multireligjioze dhe multikulturore. Buxhetin e këtyregranteve do ta sigurojë Komuna;
- t'i ndihmojë OJQ-të që e kanë këtë frymë të angazhimit për të fituar grante edhe nga donatorë vendorë e të huaj.

Komuna do të angazhohet edhe për:

- subvencionimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me jetën multikulturore;
- subvencionimin e kompanive të reja që janë në pronësi të pronarëve me përkatësi të ndryshme.

ÇAIRI I GJELBËR

Siç tashmë e dimë, Çairi viteve të fundit është shndërruar në “Komunë të Betonit”. Hapësirat publike të gjelbra gjithnjë uzurpohen dhe ngushtohen, ndërsa – në anën tjetër – Çairi mbetet komuna më e ndotur e Qytetit.

Duke e pasur edhe emrin “çair”, që nënkupton hapësirë të gjelbëruar, siç edhe ka qenë dikur, intenca jonë është që Çairin përsëri ta bëjmë çair. Çdo hapësirë publike do të jetë një mundësi për ne që do të përdoret për gjelbërim dhe për mbjellje të fidanëve.

Kemi premtim nga komuna të Republikës së Turqisë se janë të gatshme të na ndihmojnë në gjelbërimin e plotë të Çairit dhe, madje, dekorimin e tij me gjelbërim dhe lule – varësisht nga stina.

Kjo mund të realizohet edhe në bashkëpunim me OJQ të ndryshme, por gjithë ky kaos urban dhe kjo ndotje e ajrit patjetër që do të ketë zgjidhje nga ne. Çairi i Ri patjetër të bëhet çair.

Çështja tjetër mjaft brengosëse në Çair është higjiena publike. Edhe për këtë qëllim kemi diskutuar me komunat turke dhe ato kanë shfaqur gatishmëri për të na ndihmuar me pajisjet dhe përvojën e tyre në mbajtjen e higjienës publike.

Ne jemi të bindur se higjiena publike është vetëm në duart tona dhe pas katër viteve Çairi do të jetë komunë e gjelbër dhe komuna më e pastër në Qytet.

Disa nga detyrat tona në këtë drejtim janë:

- Krijimi i një “menaxhmenti të zgjuar për mbeturina” (smartwaste management). Ky është një sistemi i centralizuar softuerik që nënkupton se shportat për mbeturina do të jenë të lidhura nëpërmjet sensorëve në sistemim për menaxhim me mbeturina dhe pastrimi i tyre do të jete në kohë reale (atëherë kur do të mbushet). Ky sistem do të mundësojë uljen e kostos, kursimin e lëvizjes së kamionëve pa nevojë, përmirësimin e pastërtisë dhe efikasitet maksimal për menaxhim me mbeturina. Natyrisht, kjo duhet të realizohet në bashkëpunime Qytetin e Shkupit, në kompetenca të të cilit është higjiena publike edhe në Çair;
- Ruajtja, mirëmbajtja dhe rritja e hapësirave të gjelbra, zonave natyrore, si dhe mbrojtja e biodiversitetit;
- Rritja e efikasitetit energjetik të ndërtesave publike. Do të bëhet auditimi i plotë energjetik i ndërtesave në pronësi ose menaxhim të komunës, përfshirë një regjistër të sipërfaqeve së çatave të ndërtesave komunale. Ndërtesat publike do të kenë prioritet të lartë në masat për efikasitet energjetik, veçanërisht përmes investimit në izolim dhe në projekte të energjisë së përtëritshme, me synim të uljes së konsumit të karburanteve të ngrohjes për 40% dhe konsumit të energjisë elektrike për 15% deri në vitin 2025 për të gjitha ndërtesat në pronësi ose menaxhim të komunës. Do të aplikojmë në projekte europiane për energji efikase me synim të përmirësimit të performancës energjetike të ndërtesave komunale;
- Subvencione shtesë, krahas atyre qeveritare, për të inkurajuar kursimin e energjisë dhe praktikat e mira mjedisore, siç janë instalimi i paneleve fotovoltike, rezervuarëve për mbledhjen e ujit të shiut, etj., duke përfshirë edhe ndërtesat e banimit kolektiv;
- Do të krijohen vende të rezervuara për parkim dhe mbushje për veturat elektrike;
- Krijimi dhe subvencionimi i vend-parkimeve nëpërmjet platformës digjitale;

JETA EKONOMIKE NË ÇAIR

Ashtu siç e kemi thënë fillim, në Komunën e Çairit nuk ka hapësira për zona industriale dhe për zhvillim të bizneseve të mëdha ose të mesme, por ka mjaftueshëm kushte për realizim të bizneseve të vogla. Për këtë qëllim Komuna e Çairit do të jetë e angazhuar që t'i stimulojë bizneset e vogla. Gjithë kjo do të bëhet që të luftohet ekonomia joformale, të stimulohet biznesi real dhe të rritet shkalla e punësimit

Duke parë se në Maqedoni gati 1/3 e të rinjve janë të papunë, në frymë të zhvillimit ekonomik do të krijohen kurse për përgatitje profesionale, që do të organizohen për qytetarë të moshës së mesme, në mënyrë që të ndihmohen për gjetje të punës ose për hapje të bizneseve personale. Këto projekte në Kosovë mbështeten nga Banka Botërore, ndërsa Komuna e Çairit, duke marrë pjesë me buxhetin e saj, do të mund të thithë fonde për realizimin e këtyre kurseve.

Do të krijohen fond nga buxhetit i Komunës për të ndihmuar bizneset e reja. Nëse një i ri dëshiron të hapë biznes dhe ka siguruar një shumë mjetesh financiare, Komuna – përmes vlerësimit të planit të biznesit, që do ta bëjë Bordi i Biznesit (i krijuar nga biznesmenë dhe profesionistë) – do të participojë po me atë shumë, nga ana tjetër, që kështu të rinjtë të stimulohen për biznese.

Një dimension i veçantë i zhvillimit ekonomik do të jenë kontaktet me mërgatën dhe bashkëpunimi me të për të krijuar kushte biznesi në Çair.

Shprehur më pika të veçanta, disa nga këto detyra janë:

- Për të rritur punësimin, ne do të miratojmë masa në nivele të ndryshme. Shërbimet e punësimit komunal do të punojnë në mënyrë efektive, në mënyrë që punëkërkuesit të marrin oferta pune sa më shpejt të jetë e mundur;
- Lidhur me taksën komunale dhe pronën e paluajtshme, ne do të mbështesim një politikë të moderuar tatimore, që parandalon rritjen e niveleve të taksimit shumë të lartë;
- Do të krijohet një bord nga biznesmenë të respektuar dhe bankierë. Komuna do të fusë një shumë të hollave dhe pastaj do të hape konkurs për fillimin e bizneseve nga të rinjtë e Çairit “1 për 1” - për 1 euro investim Komuna do të japë 1 euro. Bordi, natyrisht, do të bëjë vlerësimin e idesë për biznes. Po ashtu, Bordi do ta ketë për detyrë edhe ta mentorojë biznesin;
- Një detyrë tjetër e këtij bordit do të jetë që bizneset e mëdha nga pronarë që vijnë nga Çairi ose kanë qenë ndonjëherë banorë të Çairit të blejnë shërbime dhe mallra nga kompani të vogla nga Çairi;
- Me financat e donuara do të financohen kurse për punësueshmëri për të rinjtë. Natyrisht, Bordi do t'i aprovojë aplikimet e të rinjve për kurse. Kurset mund të jepen nga kompani të specializuara ose të rinjtë mund të futen 3-5 muaj të punojnë nëpër kompani të ndryshme, me ç'rast shpenzimet do të paguhen nga ky fond. Nëse i riu dëshmohet i suksesshëm dhe kompania ka nevojë, mund ta mbajë në punë. Në këtë mënyrë do të stimulohet edhe hapja e bizneseve të reja dhe rritja e sektorit privat.

10-të top-projektet kryesore të Komunës së Çairit në mandatin 2021-2025